# FORCA JONË

*** Viti VI • Nr. 56 • Prill 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës ***


## Ministri Haki Demolli priti zëvendës ndihmësin e sekretarit amerikan të shtetit për çështje evropiane dhe euroaziatike, Hoyt Brian Yee



Ministri i FSK-së, Haki Demolli, më 29.03.2017, priti në takim zëvendës ndihmësin e sekretarit amerikan të shtetit për çështje evropiane dhe euro aziatike, z. Hoyt Brian Yee. Në takim merrnin pjesë edhe zëvendësministri Muhamet Latifi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kurse zotin Yee, e shoqëronin atasheu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, kolonel Jeffrey H. Fisher dhe këshilltari ushtarak Joshua Rubin. Me këtë rast, Ministri Haki Demolli, në emër të Ministrisë dhe FSK-së e falënderoi zëvendës ndihmësin e sekretarit amerikan të shtetit për çështje evropiane dhe euro aziatike, z. Hoyt Yee, për ndihmën që SHBA-të po japin për FSK-në, vlerësoi lartë bashkëpunimin e dy shteteve dhe në veçanti Partneritetin e Bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ministri Demolli e njoftoi z. Yee edhe me bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar, pjesëmarrjen e FSK-së në shumë trajnime me karakter rajonal, si dhe sukseset e arritura në garat ndërkombëtare. Gjithashtu ministri Haki Demolli, zotin Yee e njoftoi edhe për bashkëpunimin me DIRI-in në procesin e planifikimit të transformimit të FSK-së, si edhe me ecurinë e zhvillimit të procedurave për projektligjin për zgjerimin e misionit të FSK-së. Nga ana e tij, zëvendës ndihmësi i Sekretarit Amerikan të shtetit për Çështje evropiane dhe euro aziatike, z. Hoyt Yee, falënderoi ministrin Demolli për pritjen dhe përcolli mesazhin se Uashingtoni zyrtar është i shqetësuar rreth procesit të transformimit të FSK-së me ligj.

## Në MFSK u mbajt trajnimi "Ndërtimi i Integritetit për Liderët e Lartë"



Pjesëtarë të lartë të Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, nga data 27-30 mars 2017, për katër ditë rresht ndoqën trajnimin me temë: "Ndërtimi i Integritetit për Liderët e Lartë", të mbajtur nga instruktorë të Akademisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar. Në ditën e parë të trajnimit, ministri i MFSK-së, Haki Demolli, falënderoi Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe për bashkëpunimin e ngushtë me MFSK-në dhe FSK-në. Ndërkaq, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, z. Ruairi O'Connell falënderoi ministrin Demolli për vlerësimin dhe premtoi ndihmë për FSK-në edhe në të ardhmen, duke theksuar se FSK-ja është institucioni më i besuar për qytetarët e Kosovës Në përmbyllje të këtij trajnimi, sot nën organizimin e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, në hotelin SIRIUS, u mbajt ceremonia e certifikimit për pjesëmarrësit e këtij trajnimi. Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjatë fjalës së tij të mbajtur me këtë rast, veç tjerash vlerësoi lart ndihmën e pakursyer të Akademisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar që po jep për shkollimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së. Gjeneral Rama tha se këto trajnime janë me interes të veçantë për FSK-në, sepse janë të lidhura drejtpërdrejtë me ngritjen e integritetit të saj. Ai, ndër tjera u shpreh se: "Kurs i Zhvillimit të Integritetit për udhëheqës të lartë fokusohet tek kolonelët/nënkolonelët dhe më lart, në grada ekuivalente ushtarake dhe civile, nga sektori i gjerë i mbrojtjes dhe sigurisë, për të shqyrtuar aspektet kryesore të adresimit të rrezikut të korrupsionit në kuadër të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë, në fushat e financave, blerjeve dhe prokurimit, menaxhimit të resurseve njerëzore dhe tek operativa. Ne aspirojmë të jemi pjesë e NATO-s. NATO-ja tashmë ka një Politikë të Zhvillimit të Integritetit, e cila është nënshkruar nga 28 shtetet në Samitin e Varshavës, në korrik të vitit 2016, dhe është edhe një nder kriteret kryesore për të qenë pjesë e saj", - tha gjeneral Rama.

## FSK-institucioni më i besueshëm në Republikën e Kosovës

**1.Ju lutem na tregoni se sa i besoni institucioneve të më poshtme në çështjet e sigurisë?**

| | N | Minimum | Maximum | Mean | Std. Deviation |
|---|---|---|---|---|---|
| Presidentit | 1056 | 1 | 5 | 2.22 | 1.306 |
| Kryeministrit | 1054 | 1 | 5 | 2.00 | 1.155 |
| Ministrit të Punëve të Brendshme | 976 | 1 | 5 | 2.06 | 1.039 |
| Policisë së Kosovës | 1046 | 1 | 5 | 3.65 | 1.263 |
| Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës | 970 | 1 | 5 | 2.45 | 1.123 |
| Ministrit të Forcës së Sigurisë | 987 | 1 | 5 | 2.88 | 1.311 |
| Forcës së Sigurisë së Kosovës | 1054 | 1 | 5 | 3.74 | 1.349 |
| Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës | 964 | 1 | 5 | 2.39 | 1.142 |
| Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës | 944 | 1 | 5 | 2.14 | 1.041 |
| Komisionit Parlamentar për Inteligjencë | 915 | 1 | 5 | 2.10 | 1.022 |

Tabela 1. Besimi i përgjithshëm në institucione

"Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave KIPRED", më 24 mars 2017, para mediave bëri shpalosjen e matjeve të opinionit publik kosovar të periudhës 15 nëntor 2016 deri me 15 shkurt 2017, për institucionet e sigurisë në vend dhe për drejtuesit kryesor të këtyre institucioneve. Sipas rezultateve të prezantuara edhe këtë radhë, për herë të pestë (5), FSK rezulton se është vlerësuar si institucioni më i besueshëm i sigurisë në Kosovë, me shkallën më të lartë 3.74. Kurse në vlerësimin e drejtuesve të institucioneve të sigurisë, ministri i MFSK-së zoti Haki Demolli është vlerësuar me shkallën më të lartë 2.88. Sipas publikimit, Forca e Sigurisë së Kosovës besueshmërinë më të lartë, sipas rajoneve e ka nga qytetarët shqiptarë të veriut të vendit, përderisa ka ndryshime të shifrave në përqindje në rajonet tjera, që gjithashtu besueshmëria për FSK-në është e lartë. Këto vlerësime janë pasqyrim i rezultateve të punës së palodhshme dhe të përkushtuar të të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Ky rezultat është edhe pasojë e menaxhimit dhe drejtimit shumë transparente të MFSK-së dhe FSK, në kryerjen e detyrave që dalin nga misioni aktual që kanë. Sigurisht se këto vlerësime të larta edhe më shumë e obligojnë FSK-në dhe MFSK-në, që edhe në të ardhmen të angazhohen edhe më shumë në realizimin e objektivave të planifikuar dhe kryerjen e detyrave të përgjithshme, që dalin nga Plani i Veprimit Vjetor të Punës.

Në takim, nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, morën pjesë, gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Departamentit të Operacioneve dhe Ibrahim Shala, drejtor i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun, si dhe deputet e përfaqësues të institucioneve tjera të sigurisë.

# Ministri Haki Demolli e takoi ambasadorin e Kanadasë në Kosovë



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, z. Haki Demolli, priti sot ambasadorin jo-rezident të Kanadasë në Republikën e Kosovës, z. Daniel Maksymiuk, të cilin z. Demolli e falënderoi për përkrahjen që Kanadaja dhe Ministria e saj e Mbrojtjes po japin për MSK-në. Ministri Demolli dhe ambasadori Maksymiuk biseduan edhe për marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Kanadasë, me theks të veçantë për bashkëpunimin e mirë ndërmjet dy ministrive të Mbrojtjes. Ministri Demolli, me këtë rast, e njoftoi ambasadorin me zhvillimet e përgjithshme në FSK dhe me zhvillimet rreth projektligjit për FSK-në. Gjithashtu ministri Demolli dhe ambasadori Maksymiuk biseduan edhe për mundësitë e bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Kanadasë, por edhe në fusha tjera përkatëse në nivel vendi. Nga ana e tij, ambasadori Daniel Maksymiuk premtoi se do të angazhohet për thellimin e bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Kanadasë edhe në fusha tjera, dhe në këtë kontekst edhe në mes FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Kanadasë.

# Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, më 8 mars 2017, vizitoi Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, për një vizitë urimi dhe bashkëbisedimi me kadetët dhe oficerët e FSK-së. Zotit Veselit, mirëseardhje i dëshiruan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zëvendës komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe komandanti i QSU-së, major Avni Kiqina. Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli, në njërën nga sallat e Qendrës për Studime Universitare, takoi kadetët e FSK-së, ku u shpreh se ndihet i privilegjuar, "që sot jam para jush, për t'ju informuar për hapat të cilët po mirën për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës". FSK-ja, që nga viti 2013 i ka arritur kapacitet e saj, për ta ndryshuar misionin. Duke ju drejtuar kadetëve tha: " Ju keni krijuar mundësinë që Kosova të jetë para një vendimi historik. Siç e dini, presidenti i Kosovës, dje ka marrë një vendim i cili është në interesin e vendit tonë, me qëllim tërësisht paqësor, në mbështetje të qytetarëve të vendit dhe në fqinjësi të mirë me të gjithë fqinjët, por edhe me qëllimin e shenjtë, mbrojtjen e vendit tonë. Ushtria e Kosovës do të ketë për mision, Paqen në vend dhe rajon, do të jemi kontribuues të paqes me partnerët tanë, ku do që kërkohet, dhe njëherë jemi populli më liridashës, dhe nuk kemi as një pretendim përveç atij të paqes në rajon dhe në botë" theksoi në fund, z. Veseli.

# Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti ambasadorin e Sllovakisë Lubomir Batary



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 22.03.2017, priti në takim shefin e zyrës ndërlidhëse të Republikës së Sllovakisë në Republikën e Kosovës, ambasadorin Lubomir Batary. Gjatë takimit që gjeneral Rama zhvilloi me ambasadorin Batery u shpreh se, FSK-ja ashtu siç është e përkushtuar për ruajtjen e vlerave të vendit tonë, po ashtu me të njëjtën gatishmëri dhe përkushtim përkujdeset edhe për ruajtjen e vlerave të popujve, të cilët kanë kontribuar për lirinë dhe paqen e vendit tonë. Ai tha se, FSK-ja me kënaqësi ka ndërmarrë iniciativën për riparimin e memorialit kushtuar ushtarëve të Forcave të Armatosura të Sllovakisë, të cilët patën humbur jetën në një fatkeqësi ajrore pas përfundimit të misionit në vendin tonë. Nga ana e tij, ambasadori i Republikës së Sllovakisë, Lubomir Batery, në emrin e tij personal dhe në emër të Forcave të Armatosura të Sllovakisë dhe në emër të popullit sllovak falënderoi komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, për angazhimin dhe kujdesin e treguar në përkujtim të jetës dhe veprës së ushtarëve sllovakë. Vlen të shtojmë se, FSK-ja ka riparuar memorialin i cili u kushtohet 42 ushtarëve sllovakë të cilët kanë humbur jetën para 11 vitesh në një fatkeqësi ajrore, gjatë kthimit të tyre në atdhe, pas përfundimit të misionit në kuadër të KFOR-it.

# Komandantja e KDS-së së FA të Shqipërisë gjeneral brigade Manushaqe Shehu vizitoi MFSK-në dhe FSK-në




Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në takime të ndara pritën një delegacion të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në krye me gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Në fillim të takimit, ministri Haki Demolli u shpreh se bashkëpunimi i mirë bilateral dhe vëllazëror midis Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë është duke u kultivuar dhe zhvilluar çdo ditë e më shumë dhe me rezultate konkrete në gjitha fushat, dhe se ky bashkëpunim sidomos është me rëndësi të veçantë sepse ka të bëjë me shkollimet, trajnimet dhe ngritjen profesionale të pjesëtarëve dhe njësive të FSK-së. Nga ana e saj, gjeneralja e parë shqiptare, zonja Manushaqe Shehu u shpreh se ndjehet e lumtur që në vizitën e saj të parë si gjeneral në FSK sheh zhvillim dhe avancim të shkëlqyeshëm. Gjeneral Shehu tha gjithashtu se vizita në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe më parë ajo në kazermën ,,Skënderbeu", ia kanë forcuar bindjen se FSK-ja është në rrugë të mbarë dhe të drejtë në arritjen e synimeve dhe qëllimeve të saj, për të qenë Forcë e Armatosur e Kosovës. Gjithashtu, në takimin e përbashkët që zhvilluan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe gjeneral brigade Manushaqe Shehu, biseduan për bashkëpunimin e deritanishëm në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në veçanti rreth bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve në fushën e arsimimit, trajnimit dhe shkëmbimeve profesionale ndërmjet dy forcave.

Delegacioni i FA të Shqipërisë realizoi një vizitë pune edhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, ku u pritën nga komandanti i saj, gjeneral brigade Enver Cikaqi, i cili e njoftoi delegacionin nga Shqipëria me misionin, detyrat dhe përgjegjësitë aktuale që ka KDS-ja, me synimet e saj në të ardhmen si dhe me përgatitjet rreth fazës së transformimit. Gjatë takimit u bisedua edhe për bashkëpunimin në shumë fusha si dhe shkëmbimin e përvojave. Gjeneral brigade, Manushaqe Shehu premtoi mbështetje për KDS-në në të gjitha fushat në të cilat ka nevojë, si duke ofruar trajnime, kuadro të specializuara apo literaturë të nevojshme. Më pas shefi i shtabit të KDS-së, nënkolonel Fadil Hoxha, bëri një prezantim të shkurtër për të pranishmit lidhur me aktivitetet e KDS-së. Të dy delegacionet vizituan edhe qendrat stërvitore, për t'u njohur nga afër me trajnimet dhe kurset që zhvillohen në këto qendra.

FORCA JONË

**Botues:** Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
**Adresa:** MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
**Adresa elektorinike:** informimi.mfsk@gmail.com
**Tel:**038/551-379
**Web:** www.mksf-ks.org

# FSK-ja shënoi 19 vjetorin e Epopesë së UÇK-së



Në Kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës, më 5 mars 2017, u mbajt manifestimi qendror në shënimin e 19 vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në nderim të Komandanti Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Ky manifestim u mbajt nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa. Në manifestim ishin të pranishëm: Kryetari i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës zotëri Kadri Veseli, kryeministri i Kosovës zotëri Isa Mustafa, ministri i MFSK-së zotëri Haki Demolli, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadorë, ministra, deputet, veteranë, invalidë dhe përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, qytetarë dhe nxënës të shkollave të Kosovës. Pas revistës që iu bë kuadrateve të FSK-së, nga kryetari Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas intonimit të himnit shtetërorë dhe kombëtar, drejtuesit e shtetit dhe përfaqësuesi i veteranëve të UÇK-së, vendosën kurora me lule pranë Obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Në manifestimin "Epopeja e UÇK-së", kryetari Hashim Thaçi, në fjalën e tij, pos tjerash tha: "Kushtetuta moderne e Kosovës, mua si Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës më jep kompetenca të mjaftueshme për të ndërmarr iniciativa për të ndryshuar ligjin për FSK-në". Ai duke iu drejtuar të pranishmëve, shtoi: "Para nesh të nderuar qytetarë janë rreshtuar pjesëtarët e FSK-së e që për mua si Komandant Suprem, dhe mbi të gjitha për ju qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, këta janë ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Asnjë qëndrim i caktuar i qarqeve jo dashamirëse nuk mund ta njollosë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Ajo mbetet trashëgimia jonë më e madhe dhe më e pasur që ka krijuar historia e Kosovës. Ashtu siç do të jetë e përjetshme dhe e vlerësuar lart sakrifica sublime e Jasharëve dhe gjithë dëshmorëve të Kosovës, ashtu do të jetë i përjetshëm lavdia dhe emri i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj të nderuar ushtarë të FSK-së, unë sot dua të bëj të qartë publikisht se në ditët në vijim shumë shpejt, brenda kompetencave të mia kushtetuese, do të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore që transformimi i shumëpritur i themelimit të Ushtrisë së Kosovës të bëhet edhe nëpërmjet ndryshimit të ligjit për FSK-në", e përmbylli fjalën e tij, kryetari i Kosovës Hashim Thaçi. Ndërsa kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa në fjalën e tij, ndër të tjera theksoi: "Epopeja e UÇK-së" për çdo qytetar të Kosovës është festë e lirisë së Kosovës, është kremtja e vlerave të atdhedashurisë, patriotizmit dhe sakrificës sublime për Kosovën. Kosova, institucionet e saj, si dhe qytetarët kanë sfidat e veta, që janë të shumta dhe të cilat ndryshojnë krahas prosperitetit tonë. Kosova ka bërë transformime epokale dhe historike, falë rezistencës së saj paqësore, unike për këtë pjesë të botës, falë luftës çlirimtare të popullit të saj. Ne sot mburremi me institucionet e reja shtetërore të ngritura në partneritet me miqtë tanë, mburremi me Forcën e Sigurisë së Kosovës, në të cilën shohim ushtrinë tonë, një forcë paqeje e stabiliteti jo vetëm në rajon por edhe më gjerë, një anëtare të ardhshme të Aleancës Veri atlantike. Kemi policinë, institucionet e sigurisë të afta dhe të organizuara sipas standardeve më të larta". Në përfundim të manifestimit Trupa Muzikore e FSK-së ekzekutoi disa pika muzikore.





## Ministri dhe Komandanti i FSK-së, bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz

Në përvjetorin e 19 të Epopesë së UÇK-së dhe në nderim të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit, një delegacion i Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së, të prirë nga ministri Haki Demolli, e ku merrnin pjesë edhe zëvendësministri Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, stafi i lartë i Ministrisë dhe oficerë të lartë të FSK-së, në shenjë nderimi vendosën kurora me lule dhe bënë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Gjithashtu Ministri i FSK-së, zoti Haki Demolli së bashku me delegacionin e FSK-së, vizituan edhe familjen Jashari, ku u pritë nga zoti Murat Jashari. Ministri Demolli me këtë rast, në emër të delegacionit të MFSK-së, çmoj lartë sakrificën e pashembullt të Komandantit Legjendar Adem Jashari, të familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit. "Sot, unë si ministër i FSK-së, së bashku me zëvendës ministrin, komandantin e FSK-së, dhe eprorë më të lartë të FSK-së, dolëm për të bërë homazhe në shenjë nderimi, në shenjë respekti dhe përkushtimit të veprës heroike të Komandantit Legjendar, për sakrificën e familjes Jashari dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tij. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se gjaku i tyre ka ngritur themelet e lirisë dhe gjaku i tyre është gjaku i lirisë; andaj të gjithë qytetarët përfshirë edhe institucionet kanë për obligim që të respektojnë me përkushtim veprën e tyre" tha ministri i MFSK-së, Haki Demolli.



# FSK-ja me sukses zhvilloi ushtrim

**Gjenerali Gëzim Hazrolli vlerësoi lart procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor „Veprimi i Shpejtë 10", si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe Batalionit të Tretë-të BRSH-së.**



Në kuadër të gjenerimit të Forcës për fazën e parë të vitit 2017, Batalioni i Tretë i Brigadës për Reagim të Shpejtë ka realizuar me sukses ushtrimin fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë 10" në bashkëveprim me Kuvendin Komunal të Obiliqit, i cili proces ishte në vazhdimësi. Kompania 3C e Batalionit të Tretë ka realizuar trajnimin në një cikël tremujor, i cili ka filluar nga data 10 janar 2017 dhe ka përfunduar më 16 mars 2017, duke u përmbyllur me ushtrimin fushor "VEPRIMI I SHPEJTË 10".

Trajnimi është planifikuar nga Komanda e Batalionit të Tretë dhe është realizuar në nivel kompanie, si dhe është mbështetur dhe vlerësuar nga Komanda e Batalionit të Tretë, ekipet vlerësuese të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe ekipet këshilluese të NATO-s "NALT"

Synimi kryesor i Batalionit të Tretë është që përmes këtyre ushtrimeve fushore të arrijë një bashkëveprim me komunat në zonën e përgjegjësisë së Batalionit.

Në ushtrimet e radhës planifikohet që të vazhdohet me ushtrime fushore të ngjashme me komunat tjera në zonën e përgjegjësisë së Batalionit.

Ushtrimit fushor "Veprimi i Shpejtë 10" i realizuar në bashkëveprim me KFOR-in, Komunën e Obiliqit dhe agjencitë civile, kishte për qëllim aftësimin e njësive të FSK-së për reagim në situata të jashtëzakonshme dhe të sigurisë, si dhe aftësimin e tyre për detyra individuale dhe kolektive, duke filluar që nga faza e planifikimit, faza e ekzekutimit dhe e rikuperimit.

Procesi i ushtrimit fushor ka kaluar në një fazë të detajuar të planifikimit, në veçanti vlen të ceken konferencat planifikuese ndërmjet Batalionit të Tretë, Kuvendit Komunal të Obiliqit, agjencive emergjente në nivel komune, Policisë së Kosovës, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Brigadës Zjarrfikëse Industriale të KEK-ut dhe ekipit këshillues të NATO-s.

Gjithsej kemi realizuar tri konferenca: Konferenca fillestare është mbajtur më datë 26.01.2017, konferenca kryesore më 14.02.2017, si dhe konferenca finale më 01.03.2017, përfshirë këtu edhe Brifingun për KK Obiliq. Qëllim kryesor i këtyre konferencave ishte sinkronizimi i veprimeve dhe ndërtimi i skenarëve për ushtrimin fushor.

Në konferencën e dytë kemi formuar grupet punuese për operacione dhe skenarë, ku në fakt i është dhënë forma dhe janë nxjerrë objektivat e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në ushtrim.

Batalioni i Tretë në vazhdimësi ka koordinuar veprimet me institucionet dhe të gjithë aktorët pjesëmarrës në ushtrim fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë 10".

Ushtrimi fushor ka filluar me ngritjen e gjendjes së gatishmërisë nga Komuna e Obiliqit, më 14.03.2017, fillimisht është caktuar komandanti i vend-incidentit, kryetari i komunës Xhafer Gashi. Komandanti i vend- incidentit z. Gashi ka marrë vendim për ngritjen e Qendrës Operative Lokale brenda hapësirës së termocentralit " Kosova A", ku më pas janë zhvendosur të gjithë drejtorët e drejtorive komunale dhe ka vazhduar me udhëheqjen e operacionit nga vend-incidenti. Operacionet kryesore nga Komuna e Obiliqit janë zhvilluar deri në ora 16:00L, ku Kuvendi Komunal është ballafaquar me skenarë të ndryshëm si: zjarrfikje, aksidente komunikacioni, menaxhim i turmave, ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe evakuimi i viktimave. Pas vazhdimit të gjendjes së rënduar në Komunën e Obiliqit dhe pamundësisë të vazhdimit të udhëheqjes së operacioneve për shkak të mungesës së resurseve dhe eskalimit të mëtutjeshëm të situatës, komandanti i vend- incidentit i ka dorëzuar Komandën e vend- incidentit- Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë, gjegjësisht komandantit të Kompanisë 3C, kapiten Alban Bunjakut, i cili më pas ka udhëhequr me operacionet në vend- incident.

Ushtrimi fushor ka zgjatur tri ditë, duke filluar nga data 14.03.2016 dhe duke përfun-





# in fushor ‘VEPRIMI I SHPEJTË 10’




duar më datë 16.03.2016.

Për të përcjellë nga afër ushtrimin të pranishëm ishin: Zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, kryetari i Kuvendit Komunal të Obiliqit, njëkohësisht edhe udhëheqës i operacioni në KEK, Xhafer Gashi, komandanti i Departamentit të Përbashkët-Veri, kolonel Martin Schuler (JRD-N), ushtruesi i detyrës së Komandantit të Brigadës së Reagimit të Shpejt, kolonel Xhevahir Geci, shefi i Shtabit të Brigadës për Reagim të Shpejtë nënkolonel Ejup Maqedonci, komandanti i Batalionit të Tretë nënkolonel Sylejman Cakaj, komandanti i Policisë Rajonale të Obiliqit toger Sejdi Zeqiri, etj.

Të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua gjenerali Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandant i KFT-së, i cili vlerësoi lart procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor ,,Veprimi i Shpejtë 10", si dhe koordinimin ndërmjet agjencive civile dhe Batalionit të Tretë-të BRSH-së. Ai ndër të tjera tha: "I falënderoj të gjithë të pranishmit të cilët kanë marrë pjesë në këtë ushtrim, kjo është një mundësi e jashtëzakonshme dhe një rast i veçantë që të fillojmë t'i identifikojmë kapacitetet tona si dhe të identifikojmë zbrazëtirat tonë për zhvillimin e operacioneve të tilla në menaxhimin e fatkeqësive të ndryshme. Si FSK, në kuadër të misionit që kemi, jemi gjithmonë të gatshëm që të zhvillojmë operacione të tilla sepse në këtë mënyrë zhvillojmë edhe kapacitetet tona. Po ashtu misioni i këtyre ushtrimeve është që të zhvillojmë edhe ndërveprojmë me institucionet tjera të sigurisë në vend.

Prandaj skenarë të tillë organizohen me qëllim që nesër të jemi të gatshëm të ndërveprojmë në raste të jashtëzakonshme si gjatë tërmeteve, vërshimeve dhe situatave tjera, me qëllim që të përgatitemi dhe të stërvitemi në kohë paqeje për menaxhimin e incidenteve, në mënyrë që nesër të jemi të gatshëm që secili të kryejë punën e tij, bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar. Dua të falënderoj për mbështetje edhe kryetarin e Komunës së Obiliqit, z Gashi, i cili duke qenë sot i pranishëm pati mundësi t'i shohë kapacitetet që ka brenda komunës që ai drejton. Ky ushtrim nuk do të ishte i kompletuar pa pjesëmarrjen tuaj".

Një falënderim të veçantë, gjeneral Hazrolli i shprehu KFOR-it nga Ushtria Amerikane për kohën dhe mbështetjen me helikopter në këtë ushtrim, si dhe në emër të komandantit të FSK-së gjeneral Ramës i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e këtij ushtrimi.

Të pranishmëve iu drejtua dhe kryetari i Kuvendit Komunal Xhafer Gashi i cili i falënderoi pjesëmarrësit e në veçanti falënderoi FSK-në dhe KFOR-in për bashkëpunimin, duke thënë: "Me të vërtetë po ndihem shumë i emocionuar me veprimet e FSK-së, të cilat u realizuan në koordinim me të gjitha organet kompetente për kërkim-shpëtim. Është kënaqësi e veçantë që sot këtu e kemi edhe gjeneralin i cili për së afërmi e vëzhgoi ketë ushtrim të përbashkët. Në fund, Ai falënderoi të gjithë për realizimin me sukses të ushtrimit fushor të koduar "Veprimi i Shpejtë 10". Gjatë këtij ushtrimi, pjesëtarët e Kompanisë 3C dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht për operacione ushtarake si: patrullimet, pritat, kërkim dhe kordon, rikonicion të terrenit, sulm në nivel togu, marrje e objektivave, dhënie ndihmës së parë të lënduarve, trajtimin e tyre si dhe transportimin nga vend- incidenti. Vlen të theksohet se forcat nga KFOR-i amerikan na kanë ofruar mbështetje me helikopter për evakuimin e të lënduarve (MEDEVAC). Pjesëtarët treguan vendosmëri dhe moral të lartë për realizimin e misionit".

Në këtë ushtrim kanë marrë pjesë edhe njësitë të specializuara të FSK-së nga Brigada për Mbështetje Operacionale (MKAB dhe KSH). Gjithashtu edhe Kompania 3A dhe Kompania 3B e Batalionit të Tretë kanë qenë të angazhuar në ushtrimin në vendkomandë (UVK).

Në ditën përfundimtare të këtij ushtrimi u ekzekutuan gjithsej shtatë operacione të ndryshme si: Menaxhimi i turmave, Zjarr në lokacione urbane, Aksident komunikacioni, Trajtim mjekësor, Kërkim-shpëtim me litar, Zonë e kontaminuar, Operacione urbane, si dhe me mbështetjen e KFOR-it në tërheqjen e të lënduarve me helikopter. Për më tepër ky ushtrim dëshmoi që Batalioni i Tretë është i përgatitur dhe ka kapacitete të ekzekutojë operacione, si njësi e pavarur në terren, për të realizuar qëllimin e komandantit.





# Komandanti i Akademisë së nënoficerëve të armatës së 7-të Ushtrisë Amerikane vizitoi KDS-në

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjeneral brigade Enver Cikaqi, priti në një takim delegacionin e Akademisë së nënoficerëve të armatës së 7-të të ushtrisë amerikane, të kryesuar nga rreshter majori Gregory Smith-komandant i Akademisë së nënoficerëve. Me këtë rast, gjeneral Cikaqi falënderoi delegacionin e akademisë së nënoficerëve për mbështetjen që po i japin nënoficerëve të KDS-së, e posaçërisht instruktorëve të saj për realizimin e trajnimeve të fushave të ndryshme. Takimin me delegacionin e Akademisë së nënoficerëve nga SHBA-të, me të gjithë rreshter majorët komandues të njësive të FSK-së e hapi rreshteri i parë i KDS-së Xhevdet Mataj. Në këtë takim Rreshter majori i Komandës së FSK-së Genc Metaj i njoftoi mysafirët me të arriturat e nënoficerëve të FSK-së, si dhe foli për planifikimin dhe trajnimet që do të realizohen në të ardhmen. Po ashtu ai falënderoi delegacionin nga ushtria e SHBA-ve për mbështetjen e vazhdueshme që po jep, duke filluar nga certifikimi i instruktorëve për kurset e ndryshme profesionale dhe mbështetjen në fushën e mentorimit dhe këshillimit, si dhe për mbështetje me trajnerë në trajnime nga Akademia e nënoficerëve, të adoptuara për nevojat dhe kushtet e FSK-së. Komandanti i Akademisë së nënoficerëve rreshter majori Gregory Smith i shoqëruar nga nënoficerë tjerë pas takimit u shpreh se; vërtetë ndjehet i lumtur që po sheh këto të arritura të pjesëtarët e FSK-së, sidomos te instruktorët, që për një kohë të shkurtër kanë arritur të zhvillojnë kurset e tyre dhe të avancojnë në nivel kaq të lartë. Delegacioni i Akademisë së nënoficerëve nga ushtria e SHBA-ve, të shoqëruar nga nënoficerët e FSK-së, vizituan disa nga trajnimet të cilat po zhvillohen në KDS, për ti parë nga afër kualitetet që ofrojnë instruktorët dhe shkollat në KDS. Bashkërisht nënoficerët e FSK-së dhe ata të Akademisë së 7-të u dakorduan, që të vazhdojë kjo formë e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, me qëllim që të avancohen kapacitetet trajnuese, por edhe të certifikohen instruktorë për fushat që FSK ka nevojë. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes organizon stërvitje individuale dhe kolektive për nënoficerët e KDS, ndërsa Akademia e nënoficerëve dhe kampi Bondstill me instruktorë e tyre, kanë ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme ngritjen dhe zhvillimin e nënoficerëve të FSK-së.



# Certifikohen 24 pjesëtarë të FSK-së në trajnimin mjekësor "Personi i parë në vendngjarje"

Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, më 3.03.2017, u mbajt ceremonia e certifikimit të pjesëtarëve të FSK-së, të cilët për dy javë kryen trajnimin mjekësor," Personi i parë në vendngjarje" të mbajtur nga instruktorët Britanisë së Madhe. "Është shumë me rëndësi kur jeni në mision apo betejë, dhe kur e dini se nëse ndodh të plagoseni rëndë është dikush pran jush, që mund të ju mbaj gjallë, deri sa të vjen ndihma profesionale mjekësore dhe kjo e rrit moralin e luftës" tha në fillim të fjalës së tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, për të shtuar se: "Prej një ushtari kërkohet jo më shumë se të jetë fizikisht i përgatitur, të dinë të përdor armët dhe të jetë në gjendje ta ndihmojë shokun në raste lëndimi". Komandanti i FSK-së, duke ju drejtuar pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kryen trajnimin, tha: "Ju duhet t'i përdoreni këto shkathtësi edhe nëse jeni jashtë detyrës, mos harroni atë që keni mësuar. Si ushtarë që jeni, ju gjithherë duhet të jeni shembull dhe në gjendje për t'u përballuar në situata të vështira. Ju tani keni aftësi shtesë të cilat ju mund të përdorni për të marrë përgjegjësinë e një incidenti dhe të kujdeseni për njerëzit, pa marrë parasysh gradën e juaj". Trajnimin me profesionalizëm e kanë mbajtur instruktorë nga Mbretëria e Bashkuar të udhëhequr nga Derbyshire Stronge (International) Ltd dhe është financuar gjithashtu nga Ministria e Mbrojtjes të Mbretërisë së Bashkuar". Në fund komandanti i FSK-së, falënderoi Mbretërinë e Bashkuar si dhe instruktorët që e kanë kryer me sukses këtë trajnim, shumë të nevojshëm për FSK-në. "Unë e falënderojë David Derbyshirë dhe ekipin e tij; Mike Kelly dhe Caroline, për mbështetje dhe trajnimin e tyre të shkëlqyer". Ndërsa këshilltari i Komandantit të FSK-së, nënkolonel Gregor Lindsay, pos tjerash, tha: " Ju tani keni një grup të gjerë të përgatitur të ndihmës së parë. Tani e dini se si të veproni; të matur dhe pa kurrfarë shqetësimi në raste të një incidenti, kur njerëzit janë të plagosur rëndë. Nëse ju gjeni veten në një incident të tillë, mos kini frikë, për të qenë personi i parë në vendngjarje, dhe që duhet t'i përdorni aftësitë tuaja profesionale. Çdo ushtar i cili përdor aftësitë e tyre në një situatë të tillë, të vështirë, do të jetë një kredi për FSK-në". Nënkolonel Lindsay përgëzoi pjesëtarët e FSK-së: "Ju jeni duke punuar shumë dhe pas përfundimit të provimeve me shkrim dhe ato praktike, ju keni arritur të njëjtin nivel të kompetencës si kolegët tuaj në Mbretërinë e Bashkuar. Ushtria britanike e sheh ndihmën e parë si një mision aftësi kritike për ushtarët që shkojnë në operacionet. Kjo është arsyeja pse juve ju duhet të merri njohuri nga ndihma e parë, në mënyrë serioze këtu në Kosovë. Në të ardhmen ne mund të veprojmë në operacionet e mbështetjes së paqes së bashku. Unë personalisht jam i kënaqur që të dini se në qoftë se unë do të shërbej së bashku me një prej jush e di se nëse plagosem në këtë mision, ju do të keni aftësi për të më mbajtur gjallë" tha në fund këshilltari i komandantit të FSK-së. FSK-ja gjatë pesë viteve të fundit ka kryer trajnime të drejtpërdrejta mjekësore, në nivele të ndryshme, nga Derbyshire Stronge. Gjatë dy javëve, 24 pjesëtarë janë trajnuar në trajnimin, personi i parë në skenë. Award Intermediate është një kualifikim i cili është i njohur ndërkombëtarisht, dhe është i përshtatshëm dhe mund të jetë shumë i dobishëm për të ndihmuar në aspirata afatgjata për të zhvilluar një aftësi mjekësore të vetë-qëndrueshme brenda FSK-së, por edhe në FAK. Është planifikuar që studentët më të mirë në këtë kurs, do të bëhen instruktorë mjekësorë, brenda njësive të tyre.



# Kompania 2B e Batalionit të II-të të BRSH-së përfundoi me sukses trajnimin tremujor "Gjenerimi i Forcës"

Pjesëtarët e Kompanisë 2B të Batalionit të II-të të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, me realizimin e ushtrimit fushor 72 orësh "UJKU VIGJILENT 01" përfunduan trajnimin e brendshëm tremujor "Gjenerimi i Forcës", i cili ka filluar më 16 janar 2017 dhe ka përfunduar më 30 mars 2017. Ushtrimi fushor i planifikuar nga Komanda e Batalionit të Dytë, u realizua në fshatrat e Komunës së Rahovecit dhe Malishevës( konkretisht në fshatrat Mrasor dhe Llapqevë), i cili është mbështetur edhe nga vëzhguesit e NALT-it, KFOR-it dhe kontrollues-vëzhguesit e KDS-së. Gjatë këtij ushtrimi pjesëtarët e Kompanisë 2B-dëshmuan se janë të përgatitur profesionalisht në operacionet ushtarake, siç janë: rikonicion të terrenit, pika të kontrollit, patrullimet me blinda, reagim në kontakt, kordon-kërkim, sulm i planifikuar i bazës së armikut në nivel togu, prita, mbrojtje gjatë marshimeve rrugore, vetëmbrojtje të afërt, perimetër të sigurisë, navigim, marshime kondicionale të shpejta me peshë, baza patrulluese 24 orësh, poligon taktik, qitje e avancuar me municion real luftarak dhe fusha tjera. Gjatë trajnimit janë realizuar tri teste, me qëllim të vlerësimit të shkathtësive grupore dhe individuale të pjesëtarëve, si: teste fizike, teste akademike mbi njohuritë taktike dhe teste të përgjithshme. Ushtrim fushor "Ujku Vigjilent 01", ishte produkt i trajnimit tremujor të kompanisë, ku gjatë kësaj kohe pjesëtarët e kompanisë rifreskuan dhe realizuan tema të reja taktike profesionale- ushtarake. Këto trajnime kanë për qëllim mbajtjen në nivel të pjesëtarëve të FSK-së dhe rritjen e gatishmërisë së tyre.



# Instruktorë nga KFOR-i amerikan realizuan trajnimin dyjavor në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së

Në kuadër të bashkëpunimit mes Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) dhe Grupit Shumëkombësh Luftarak Lindje (Bondstill) është realizuar një trajnim i cili përmban një cikël ligjëratash nga fusha ushtarake. Gjatë periudhës 13-23 mars 2017 janë realizuar ligjërata lidhur me procesin e vendimmarrjes ushtarake, ku kanë marrë pjesë oficerë dhe nënoficerë të KDS-së. Gjatë trajnimit, instruktorët amerikanë kanë punuar në ekip me pjesëtarët e KDS-së, me qëllim që trajnimi të jetë sa më efikas dhe pjesëtarët të marrin sa më shumë njohuri nga kjo fushë. Pas përfundimit të trajnimit, është mbajtur edhe ceremonia e certifikimit, ku ishin të pranishëm: komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi; kolonel Irfete Spahiu, zëvendëskomandant i KDS-së; komandanti i Bondstillit kolonel Cory Lusk; nënkolonel Scott Virgil nga kampi ushtarak në Novosellë, si dhe oficerë të lartë të KDS-së dhe të KFOR-it amerikan. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi falënderoi komandantin e Bondstillit për angazhimin e pjesëtarëve të tij në realizimin e këtij trajnimi, ndërsa theksoi se "pjesëtarët e kampit Bondstill janë duke kontribuuar në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin dhe avancimin e pjesëtarëve të KDS-së për çka ju jemi mirënjohës, ne kemi pas edhe në të kaluarën bashkëpunim me kampin



Bondstill dhe më vjen mirë që tashmë është krijuar edhe një traditë e bashkëpunimit mes dy kazermave. Ne jemi të përkushtuar që të vazhdojmë këtë bashkëpunim dhe vlerësoj se mbështetja juaj në lëmin e stërvitjeve është e nevojshme të ndodhë edhe në të ardhmen". Komandanti i Bondstillit-kolonel Cory Lusk në fjalën e tij tha, se "ne kemi përzgjedhur një ekip të përgatitur mirë për realizimin e trajnimit, bazuar në kërkesën tuaj dhe planifikimin mes dy shtabeve, për çka sot po flasin edhe rezultatet. Ai gjithashtu theksoi se ka vlerësime pozitive për përvojën e pjesëtarëve të KD-së, por edhe për interesimin e treguar për të marrë njohuri sidomos në fushën e vendimmarrjes ushtarake". Në kuadër të ceremonisë, për rolin e këtij trajnimi foli shefi i Shtabit të KDS nënkolonel Fadil Hoxha, i cili përmes një prezantimi të shkurtër paraqiti të arriturat nga ky trajnim, i cili u vlerësua si shumë frytdhënës. Ceremonia e certifikimit mbaroi me shpërndarjen e diplomave për pjesëtarët pjesëmarrës, ndërsa komandanti i KDS gjeneral brigade Enver Cikaqi ndau mirënjohje për instruktorët amerikanë, në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë gjatë këtyre dy javëve.

# Në FSK u mbajt takimi i deputetit Qerim Bajrami me pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti boshnjak

Zyra për Çështje të Komuniteteve në MFSK, kryesuar nga drejtoresha zonja Azemina Çullum mbajti takim me temën: „Pozita dhe statusi i pjesëtarëve të komunitetit boshnjak në Forcën e Sigurisë së Kosovës" ku mori pjesë edhe deputeti Qerim Bajrami, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si dhe anëtar i Komitetit për të Drejtat, Interesat dhe Kthimin e Komuniteteve. Me këtë rast, zv. ministri Muhamet Latifi, në fjalën e tij theksoi se FSK është institucion i shteti të Kosovës dhe gjithë qytetarëve të saj pa dallim nga përkatësia racore, gjinore, nacionale dhe fetare, duke shpre-



hur admirimin për punën dhe përkushtimin e pjesëtarëve të FSK-së nga të gjitha komunitetet e në veçanti të komunitetit boshnjak i cili është i integruar mirë në FSK. Nga ana e tij, drejtori i drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi u shpreh se FSK-ja është unike në strukturën e saj, në të cilën kontribuojnë pjesëtarë nga radhët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në vendin tonë. Deputeti Qerim Bajrami, u shpreh se shërbimi i pjesëtarëve nga komuniteti boshnjak në FSK është krenari për komunitetin boshnjak dhe gjithashtu do të jetë nderë e krenari edhe shërbimi në Ushtrinë e ardhshme të Kosovës, dhe se komuniteti boshnjak duhet të angazhohet që të jep kontributin në zhvillimin dhe avancimin e institucioneve të vendit si dhe pjesëmarrjen dhe avancimin e pozitës së tyre. Edhe deputeti Nuredin Ibishi, anëtarë i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen Parlamentare të FSK-së, në diskutimin e tij u interesua për pozitën e komuniteteve në FSK si dhe shprehu mbështetjen për angazhimet e MFSK-së dhe FSK-së në realizmin e politikave që garantojnë perspektivë dhe trajtim të barabartë. Në këtë takim për përvojat dhe pozitën e tyre në FSK diskutuan pjesëtarët e FSK-së nga radhët e komunitetit boshnjak si: toger Edin Januz, nëntoger Ilhan Zoraniq dhe ushtare Jasmina Shabanoviq. Në takim mori pjesë edhe zëvendës drejtori i ekipit këshillues të NATO-s për MFSK dhe FSK (NALT), z. Mark Theobald si dhe oficerë e zyrtarë të tjerë nga ministria për FSK dhe FSK-ja.

# Përfundoi trajnimi i përbashkët në fushën e komunikimit mes FSK-së dhe Brigadës Shumëkombëshe Lindje

Në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, nga data 09 deri më 10 mars, është realizuar trajnimi i përbashkët në fushën e komunikimit mes FSK-së dhe ekipit mobil të Brigadës Shumëkombëshe Lindje të kampit Bonstill nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Të pranishëm gjatë trajnimit ishin zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zëvendëskomandanti i Brigadës Shumëkombëshe Lindje kolonel Jeffrey SUVER, shefi i Departamentit të Komunikimit të KFT-së nënkolonel Gyrner Murati dhe përgjegjësi për komunikim në kuadër të Brigadës Shumëkombëshe Lindje major Work Walter si dhe oficerë të FSK-së dhe KFOR-it. Ky trajnim kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe vendosjen e komunikimit të përbashkët për realizimin e ushtrimit fushor „Silver Sabre 3", i cili do të organizohet nga KFOR-i dhe është në vazhdën e mbështetjes që është duke dhënë Ushtria amerikane për Forcën e Sigurisë së Kosovës në të gjitha fushat. zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, u shpreh i kënaqur me bashkëpunimin e FSK-së me Ushtrinë amerikane, duke theksuar në veçanti rëndësinë e bashkëveprimit me kampin Bonstill rreth pajisjeve të komunikimit. Ndërkaq, zëvendëskomandanti Brigadës Shumëkombëshe Lindje, kolonel Jeffrey SUVER, u shpreh se ndjehet mjaft i kënaqur me bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës, për sa i përket përgatitjes së pjesëtarëve të FSK-së me pajisje moderne në lëmin e komunikimit. Në fund, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore dhe zëvendëskomandanti Brigadës Shumëkombëshe Lindje, theksuan se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen përmes shkëmbimit të përvojave dhe organizimit të ushtrimeve në këtë fushë.





# Në Brigadën e Mbështetjes Operacionale të FSK-së përfundoi gara për zgjedhjen e ushtarit më të mirë

Nga data 7 deri më 10 mars është realizuar gara "Ushtari më i mirë" në kuadër të BMO-së dhe njësive të saj, ku morën pjesë 11 pjesëtarë nga njësitë e BMO-së, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Batalioni i Logjistikës dhe Batalioni i Xhenios. Në ceremoninë përmbyllëse të pranishëm ishin edhe Zv. KOM FT-së, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, ZV. KOM i BMO-së, nënkolonel Avdi Rraci, KOM i Regjimentit kolonel Shaip Haziri, komandantët e njësive të lartpërmendura si dhe rreshter majorët e këtyre njësive. Gjeneral brigade Gëzim Hazrolli në fjalën e tij, të mbajtur me këtë rast, ndër të tjera tha: "Të arriturat tona janë duke u vërejtur çdo ditë, falë punës dhe përkushtimit tonë nuk po na mungojnë as rezultatet. Organizimet e tilla duhet të na shërbejnë si motiv në të ardhmen. Andaj ju përgëzoj të gjithëve, ju qe keni organizuar këtë garë dhe ju që keni shprehur guximin për të marrë pjesë dhe për t'u sfiduar. Organizimi i garës "Ushtari më i mirë" është shtrirë nëpër të gjitha njësitë e FSK-së. Dua t'ju garantoj se është interesim yni që të vlerësohen kualitetet që jeni duke i treguar, ju do të jenë një udhërrëfyes i mirë në ngritjen e standardeve në kuadër të FSK-së". ZV Komandanti i BMO-së kolonel Avdi Rraci shtoi se gara e organizuar ka karakter sfidues dhe është realizuar edhe në kuadër të BMO-së. Prandaj synimi ynë në garën e përgjithshme është që të arrijmë rezultate sa më të mira. Rreshter majori i parë i komandantit të FSK-së, Genc Metaj, e vlerësoi lart organizimin e kësaj gare, duke theksuar se gara "Ushtari më të mirë" do të ketë karakter ndërkombëtar dhe do të marrin pjesë edhe shumë vende tjera partnere me FSK-në, ku do të ketë edhe shtim të aktiviteteve dhe disiplinave që do të organizohen në kuadër të kësaj gare për vitin 2017. Kjo garë është realizuar në disa lokacione në këto disiplina: Testi fizik, Navigim tokësor, Ndihmë e parë, Kalimi i zonës së rrezikshme, Hedhja e granatës, Vëzhgimi i terrenit, Marshimi 15 km me ngarkesë10 kg. Në fund të ceremonisë u ndanë mirënjohje për tri vendet e para: Vendi i tretë i takoi ushtar-



it Albert Krasniqi- Batalioni i Logjistikës, Vendi i dytë i takoi ushtarit Hazir Aliu-Batalioni i Xhenios Vendi i parë i takoi ushtarit Besnik Nebihu-Regjimenti i Mbrojtjes Civile

Intervistë me Ahmet Sallovën shef i Sektorit-Qendra Koordinuese për Deminim në MFSK

# FSK-ja shkatërroi qindra mjete të pashpërthyera gjatë vitit 2016

Kompania e Deminimit të FSK-së, që nga viti 2010, ka pastruar shumë fusha të minuara, gjatë luftës, si dhe ka shkatëruar mijëra mjete të paekspoduara të gjetura në shumë lokacione në Kosovë, ku si pasojë e tyre, kanë humbur jetën shumë qytetarë të pafajshëm në Kosovë. Për këtë biseduam me Ahmet Sallovën-shef i Qendrës Koordinuese për Deminim në MFSK.



**Gazeta "Forca Jonë":** *Z. Sallova, cila është Qendra Koordinuese për Deminim në Ministrinë e FSK-së?*
**Ahmet Sallova:** Qendra Koordinuese për Deminim (QKD) është njëri nga katër sektorët e Departamentit të Operativës dhe Trajnimit brenda Ministrisë së FSK-së. Qendra Koordinuese për Deminim bazuar në Ligjin Nr.04/L-089 për deminim humanitar është autoritet koordinues për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të deminimit humanitar të zhvilluar nga FSK dhe organizatat e tjera në Republikën e Kosovës.

**Gazeta "Forca Jonë":** *Sa fusha kanë pastruar dhe sa mjete eksplozive kanë eliminuar njësitet e deminimit të FSK-së ?*
**Ahmet Sallova:** Kompania e Deminimit e FSK-së ka filluar operacionet e deminimit që nga viti 2010, ku falë punës profesionale të pjesëtarëve të saj, ka arritur të pastrojë mbi 1,745,465 metra katrorë nga mbi 2177 mjete të ndryshme eksplozive të pashpërthyera, duke filluar nga minat anti- personale, minat anti-tank, projektil të ndryshme, granata e municione të tjera të pashpërthyera. Ndërkaq, gjatë vitit 2016, Kompania e Deminimit ka bërë pastrimin e mbi 247,213 metrave katrorë, duke shkatërruar gjithsej 72 mjete të ndryshme të pashpërthyera, në pesë lokacione, si: në Parkun e Lirisë në Ferizaj, në Zagrmle të Pejës, në Hoçë të Prizrenit, në kazermën e FSK-së-në Ferizaj dhe në Paldenicë"., na thotë në fillim të bisedës z. Sallova. "Prej fillimit të operacioneve të çminimit të fushave të minuara, njësitet e FSK-së kanë pastruar 23 lokacione të ndryshme, edhe pse shumë nga fushat të njohura si të rrezikshme janë pastruar, ende ekzistojnë edhe 111 zona të afektuar nga minat dhe nga bombat kasetë".




**Gazeta "Forca Jonë":** *Cili është roli i ekipeve të EOD-së?*
**Ahmet Sallova:** Përveç njësive që zhvillojnë operacionet e çminimit humanitar FSK ka edhe dy njësi të EOD-së njëra në Prizren dhe tjetra në Pomozotin, të cilat 24 orë në 7 ditë kujdestarojnë për intervenime në rastet kur qytetaret hasin në mjete të ndryshme eksplozive dhe lajmërojnë për largimin e tyre. Gjatë vitit 2016 FSK ka intervenuar në 307 raste duke demoluar 371 mjete të ndryshme eksplozive.
Që nga fillimi i këtyre operacioneve pra nga viti 2010 FSK ka intervenuar në 2136 raste dhe ka demoluar 3150 mjete të ndryshme eksplozive.

**Gazeta "Forca Jonë":** *Sa është numri i personave të cilët kanë pësuar nga këto mjete eksplozive?*
**Ahmet Sallova:** Nuk duhet të harrojmë faktin se që nga koha e përfundimit të luftës e deri më sot, 117 persona kanë humbur jetën dhe 461 të tjerë janë lënduar si pasojë e minave ose mjeteve eksplozive, njofton z. Sallova.
Puna e njësive të FSK-së është shumë më rëndësi, duke marr parasysh edhe faktin se Kompania e Deminimit bën vetëdijesimin e nxënësve në sholla fillore, se si ata duhet të sillen në raste kur hasin në mina apo mjete tjera eksplozive dhe se si t'i raportojnë ato tek autoritetet përgjegjëse, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejt me to.

**Gazeta "Forca Jonë":** *z. Sallova, cila është Kompania e Deminimit në aspektin profesional?*
**Ahmet Sallova:** Kompania e Deminimit përbehet nga katër togje. Tri togje janë të trajnuara dhe të aftësuara për deminim humanitar dhe pastrimin e fushëbetejave (BAC), kurse një tog është aftësuar përveç kryerjes së deminimit humanitar edhe për kryerjen e detyrave për eliminimin e mjeteve të ndryshme eksplozive të pashpërthyera (EOD). Çdo tog i ka nga 25 pjesëtarë. Të gjitha këto njësi janë shumë profesionale dhe të përgatitura sipas standardeve ndërkombëtare për deminim, si dhe janë të pajisura me pajisje të nevojshme, ku shumica prej tyre kanë qenë donacione nga SHBA-të.